VENDIM
Nr. 514, datë 30.8.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 359, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PARIMET DHE UDHËZIMET E PRAKTIKËS SË PRODHIMIT TË MIRË TË BARNAVE, PËR PËRDORIM NJERËZOR, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për parimet dhe udhëzimet e praktikës së prodhimit të mirë të barnave, për përdorim njerëzor, në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 359, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në kreun I bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Shkronja "b", e pikës 1.5, shfuqizohet;

ii. Shkronja "b", e pikës 1.12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Kontrata përcakton qartë përgjegjësitë e secilës palë dhe shpjegon, në veçanti, respektimin e PMF-së së barnave, që duhet të ndiqet nga pranuesi i kontratës.";

b) Në "Fjalorin e termave", në përkufizimin "Person i kualifikuar", në shkronjën "b", togfjalëshi "… të paktën dy vjet …" zëvendësohet me "… jo më pak se 5 vjet …".

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama